



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË

2021

ARRU, Gusht 2022

MISIONI

“Rregullim i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

VIZIONI

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
1. HYRJE.....	6
2. PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	7
2.1 PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJË	7
2.1.1 Cilësia e ujit	7
2.1.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit	8
2.1.3 Matja e ujit	9
2.1.4 Ankesat	10
2.1.5 Konsumatorët e prekur nga presioni i ulët.....	11
2.1.6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë.....	12
2.1.7 Plasaritjet e gypave në rrjetin e ujësjellësit.....	13
2.1.8 Uji i pa-faturuar (uji i humbur).....	14
2.1.9 Volumi i ujit të prodhuar, të shitur (faturuar) dhe ujit të humbur.....	16
2.2 PERFORMANCA FINANCIARE – FURNIZIMI ME UJË	19
2.2.1 Vlera monetare e shitjeve (faturimit) (EUR)	19
2.2.2 Kostot për njësi	21
2.2.3 Kostoja operative për njësi e ujit të prodhuar	21
2.2.4 Kostoja për njësi të ujit të shitur.....	22
2.2.5 Kostoja njësi e ujit të shitur e realizuar në raport me atë të planifikuar.....	23
2.2.6 Shpenzimet kapitale për ujësjellës	23
2.3 PERFORMANCA OPERATIVE – SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA	27
2.3.1 Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara	27
2.3.2 Shpeshtësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit	27
2.3.3 Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)	28
2.3.4 Ankesat	28
2.4 PERFORMANCA FINANCIARE – SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA.....	30
2.4.1 Vlera e planifikuar e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro)	30
2.4.2 Vlera e realizuar e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura (Euro)	30

2.4.3	Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura	31
2.4.4	Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar në raport me atë të planifikuar	32
2.4.5	Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura	33
2.5	PERFORMANCA E PERGJITHSHME FINANCIARE E KRU	36
2.5.1	Arkëtimi i të ardhurave për shërbimet e ujit (ujë i pijshëm dhe ujëra të ndotur) 36	
2.5.2	Kthimi në kapital	37
2.5.3	Shpenzimet operative	38
2.5.4	Efikasiteti i stafit	40
3.	PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË	42
SHTOJCA 1:	PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	43
SHTOJCA 2:	PËRMBLEDHJE TREGUESISH 2021	46
SHTOJCA 3:	TË DHËNA STATISTIKORE 2021	47
SHTOJCA 4:	PASQYRAT TARIFORE (2020-2021)	48

LISTA E SHKURTESAVE

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
AMK	Agjencioni i Metrologjisë së Kosovës
BPRR	Biznes Plani Rregullator
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
ITU	Impianti i Trajtimit të Ujit
KNMU	Këshillit Ndërmarrës për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve-KRU
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
GNI	Grupi Ndërinstitucional (Qeveria, ARRU, KRU, SHUKOS).
PR	KRU Prishtina
PZ	KRU Hidroregjioni Jugor
PE	KRU Hidrodrini
GJA	KRU Gjakova
MIT	KRU Mitrovica
FE	KRU Bifurkacioni
GJI	KRU Hidromorava
NHE	Ndërmarrja Hidro-ekonomike

1. HYRJE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është institucion i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura në Kosovë dhe ka përgjegjësi ligjore për monitorimin e performancës dhe për hartimin e raportit vjetor të performancës të ofruesve të shërbimeve të ujit.

Ky raport paraqet gjendjen dhe nivelin e shërbimeve të ujit dhe vlerëson performancën operative dhe financiare të shtatë (7) Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) dhe të Ndërmarrjes Hidro-ekonomike (NHE) Iber Lepenci. Analizat e paraqitura në këtë raport janë bazuar në të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit të cilat janë verifikuar me auditimin e këtyre të dhënave nga ana e ARRU-së. Raporti i hartuar është një instrument informimi të publikut dhe të gjithë akterëve të përfshirë në sektorin e ujit.

Në këtë raport paraqitet performanca e sektorit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura gjatë vitit 2021 dhe është krahasuar me vitin paraprak (2020) si dhe është përshkruar niveli i përmbushjes së objektivave të planifikuara me proces tarifar për disa tregues kyç të performancës. Për arsye objektive, menaxhmenti i ARRU-se ka vendosur që në këtë raport të mos përfshihet kapitulli i rangimit të KRU-ve sipas performancës.

Në përgjithësi performanca e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura përgjatë vitit 2021 tek disa tregues ka qenë më e mirë krahasuar me performancën gjatë vitit 2020. Përmirësimin më të theksuar pothuajse të gjitha KRU-të e kanë arritur në shkallën e arkëtimit. Zhvillime pozitive gjatë vitit 2021 sektori ka pasur edhe sa i përket vazhdimësisë së furnizimit me ujë, uljes së shpenzimeve operative si dhe tek efikasiteti i stafit. Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit ka pasur gjithashtu një trend lehtësisht pozitiv, mirëpo niveli i mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura ka mbetur i njëjti me vitin 2020. Treguesi i performancës së trajtimit të ujërave të ndotura gjatë vitit 2021 gjithashtu është përmirësuar me futjen në funksion të ITUN në Prizren dhe Pejë.

Çështjet me sfiduese dhe më problematike për sektorin e ujit vazhdonë të mbetet niveli shumë i lartë i uji të pa-faturuar (UPF) i cili edhe gjatë vitit 2021 ishte 55% në nivel të njëjtë me vitin 2020 si dhe realizimi shumë i ulët i investimeve kapitale, të cilat janë të planifikuara të realizohen nga të hyrat vetanake.

Ndërsa nëse analizojmë performancën e ndërmarrjeve në raport me caqet e planifikuara me proces tarifar, mund të konkludojmë që shumica e ndërmarrjeve nuk i kanë arritur caqet në shumicën e treguesve të performancës.

Autoriteti i inkurajon ofruesit e shërbimeve të ujit të vazhdojnë angazhimin në përmirësimin e treguesve të performancës me fokus të veçantë në përmirësim të vazhdimësisë së furnizimit të rregullt me ujë, në uljen e UPF-së si dhe në realizimin e investimeve të planifikuara kapitale.

ARRU do të vazhdojë të punojë me bordet, menaxhmentin e ndërmarrjeve si dhe palët tjera të involvuara në sektor në përmirësim të performancës së ndërmarrjeve dhe përmirësim të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Ne besojmë që bashkëpunimi i ndërsjellët dhe i afërt me ofruesit e shërbimeve dhe jo vetëm, do të rezultojë në përmirësim të shërbimeve të ujësjellësit si dhe në qëndrueshmëri financiare dhe teknike të sistemeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

2. PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

2.1 PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJË

2.1.1 Cilësia e ujit

Cilësia e ujit është njëri prej standardeve kryesore të shërbimit të listuara në kornizën ligjore dhe rregulloret e ARRU-së; IKSHPK është autoriteti përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të procedurave të testimit dhe përmbushjes së këtij standardi nga ana e KRU-ve. Në lidhje me kualitetin e ujit, ARRU nuk ka pranuar të dhëna nga IKSHPK për vitin 2021, të dhënat e prezantuara në këtë raport janë bazuar në testet e kryera nga KRU-të (qoftë në laboratorët e tyre vetanake apo të kontraktuara me Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik). Të dhënat për kualitet të ujit për vitin 2020 ARRU I ka pranuar nga IKSHPK vetëm për periudhën e parë gjashtëmujore.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga KRU-të statusi i akreditimit të laboratorëve është si vijon: laboratorët e KRU Gjakova dhe KRU Hidroregjioni Jugor janë të akredituar, laboratori i KRU Prishtina ka qenë i akredituar deri në vitin 2020, por nuk kanë vazhduar akreditimin për vitin 2021. Në vitin 2022 KRU Prishtina ka aplikuar për ri-akreditim, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidrodrini janë në proces të akreditimit, përderisa KRU Mitrovica nuk ka filluar akoma me procesin e akreditimit.

Gjatë vitit 2021 janë testuar gjithsejtë 20,366 mostra prej të cilave 98.1% janë në përputhje me standardet e cilësisë së ujit për pije. Sa i përket aspektit bakteriologjik, janë testuar gjithsejtë 8,192 mostra, prej tyre 98.3% kanë qenë në përputhje me vlerat parametrike të lejuara ndërsa në aspektin e cilësisë fiziko-kimike, janë testuar 12,174 mostra nga të cilat 98% janë në përputhje me vlerat e lejuara. Rezultatet e testeve janë prezantuar në formë grafike në figurën 1 dhe 2.




Figura 1. Kualiteti i ujit: testet bakteriologjike – përputhja me vlerat parametrike të lejuara (2020 H1 dhe 2021)




Figura 2. Kualiteti i ujit: testet fiziko-kimike – përputhja me vlerat parametrike të lejuara (2020 H1 dhe 2021)

Në aspektin bakteriologjik KRU Hidromorava (90.9% përshtatshmëri) dhe KRU Hidroregjioni Jugor (91.3% përshtatshmëri) kanë patur numër më të lartë të dështimeve në raport. KRU-të tjera kanë arritë përshtatshmërinë mbi 98.5, ndërsa KRU Gjakova dhe KRU Mitrovica kanë arritur përshtatshmërinë 100%.

Në aspektin e analizave fiziko-kimike KRU Hidrodrini (71.3%) dhe KRU Bifurkacioni (92.4%) kanë pasur përshtatshmërinë më të ulët, KRU Hidromorava ka arritë përshtatshmërinë në nivelin (96.7%), ndërsa KRU Prishtina, KRU Gjakova, KRU Mitrovica dhe KRU Hidroregjioni Jugor kanë pasur përshtatshmërinë 100%.

Gjatë muajit korrik 2021 në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini, përkatësisht në disa fshatra të Komunës së Deçanit, pati një helmim masiv të popullatës, fatmirësisht pa pasoja fatale për banorët. Bazuar në të gjeturat ishte konstatuar se ndotja e ujit në disa pika të sistemit të ujësjellësit nuk i ka përmbushë standardet e parapara me Udhëzimi Administrativ 16/2012 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.

Për të siguruar një cilësi të mirë dhe qëndrueshmëri të kualitetit të ujit, investimet janë të nevojshme në burimet e ujit, sigurimi që ujërat sipërfaqësor të mos depërtojnë në pusët që shfrytëzohen për ujë të pijshëm, në impiantet e përpunimit të ujit, në rezervuarë, stacione të pompave dhe në rrjetin shpërndarës. Është gjithashtu e rëndësishme që KRU-të t'i akreditojnë laboratorët e tyre për kryerjen e analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike. KRU-të duhet të finalizojnë hartimin e Planeve për Monitorim të Kualitetit të Ujit, konform Udhëzimit Administrativ 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.

2.1.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen me ujë nga sistemet e menaxhuara nga KRU-të në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit. KRU-të aktualisht sigurojnë shërbime të ujësjellësit në vendbanimin e tyre¹ për 79% të popullatës në Kosovë. Në vitin 2021, ky tregues ka shënuar progres për 1% krahasuar me vitin 2020, kryesisht tek KRU Mitrovica dhe Hidroregjioni Jugor.

¹Të dhënat për popullatën janë marrë nga raportet përkatëse të publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (më saktë nga Raporti i Censusit 2011 dhe Raporti i Parashikimit të Popullatës 2017-2061)

Shprehur në terma të vend-banimeve, nga gjithësej 1,238 vendbanime vetëm 665 të tilla kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit që menaxhohen nga KRU-të. Duhet të potencohet se në shifrat e prezantuara nuk përfshihen vendbanimet të cilat nuk janë marrë nën menaxhim nga ana e KRU-ve. Një numër vendbanimesh kanë sisteme të tyre vetanake të furnizimit me ujë dhe menaxhohen nga komunat përkatëse apo vet komuniteti.




Figura 3. Mbulueshmëria me shërbime të ujsjellësit

Gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020, nën menaxhimin e të gjitha KRU janë shtuar 15 sisteme rurale të ujësjellësit. Ndërsa, sipas informacioneve të cilat ARRU i ka pranuar nga personat përgjegjës të projekteve që mbështesin sektorin e ujit, janë edhe 93 sisteme të furnizimit me ujë që tashmë janë të ndërtuara në zonat rurale që do të duhej të funksionalizoheshin dhe të menaxhoheshin nga KRU-të respektive.

Mbulueshmërinë pothuajse të plotë, në kudër të zonës së vet të përgjegjësisë e ka arritur vetëm KRU Gjakova me 99%, përderisa KRU Hidromorava (me 61%) dhe Hidroregjioni Jugor (me 66%) mbeten shumë më mbrapa me shtrirjen e shërbimeve të furnizimit me ujë në zonën e tyre respektive të shërbimit.

2.1.3 Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një prej standardeve të rëndësishme të shërbimit të ujit, është parakusht për një faturim të drejtë duke i ngarkuar konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real. Matja e ujit gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.




Figura 4. Përqindja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Të gjitha KRU-të kanë raportuar të kenë shënuar progres të mirë tek pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2021. KRU Mitrovica edhe përkundër progresit të arritur në vitin 2021, rritjes për 5% të konsumatorëve të pajisur me ujëmatës në raport me vitin 2020, megjithatë ende qëndron në nivel më të ulët në raport me kompanitë tjera. ARRU ka kërkuar në vazhdimësi nga të gjitha KRU-të të vendosin matjen e detyrueshme të konsumit të ujit, si një nga standardet themelore të shërbimit.

Edhe pse mbulueshmëria me ujëmatës, sipas deklaramit të KRU-ve është e lartë, çështje mjaftë shqetësuese është saktësia e matjes së ujit për shkak të vjetërsisë së ujëmatësve. Sipas kornizës ligjore të aprovuar nga Agjencia e Metrologjisë e Kosovës KRU-të janë të obliguara të kryejnë verifikimin e saktësisë së ujëmatësve çdo 5 vite. Vlerësohet se një element kyç në humbjet kaq të larta të ujit mund të jetë pasojë e ujëmatësve të vjetër.

2.1.4 Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e kënaqëshmërisë së konsumatorëve në lidhje me shërbimet e ujit që i marrin nga ofruesit e shërbimeve. Ankesat janë ndarë në dy kategori, ankesa për çështje teknike – operative dhe ankesa për çështje financiare – komerciale. KRU-të, duke qenë se kanë aplikacione softuerike të përshtatshme për regjistrim të ankesave, duhet të mbajnë një regjistr të përditësuar të ankesave të konsumatorëve, ti klasifikojnë sipas natyrës së ankesave dhe natyrisht ti zgjidhin ankesat brenda një afati kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.

Në tabelën 1 është paraqitur numri i ankesave të natyrës teknike dhe financiare, duke përfshirë edhe krahasimin me vitin 2020.


Tabela 1. Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit

KRU	Ankesat teknike			Ankesat komerciale		
	2020	2021	Raporti krahasues: 2021/2020	2020	2021	Raporti krahasues: 2021/2020
PR	2,868	3,905	36%	1,189	1388	17%
PZ	2,344	2,021	-14%	668	670	0%
PE	4,558	2,296	-50%	21	43	105%
MIT	5,099	6,785	33%	168	85	-49%
GJA	96	3	-97%	331	338	2%
FE	32	54	69%	82	137	67%
GJI	111	244	120%	88	339	285%
Totali	15,108	15,308	1%	2,547	3,000	18%

Numri i ankesave që dominojnë janë ato që kanë të bëjnë me çështje teknike – operative; vetëm afër 1/3 e ankesave janë të natyrës financiare – komerciale. Në nivel sektori për vitin 2021 vërehet një rritje e konsiderueshme e ankesave financiare, janë 18% më shumë ankesa se në vitin 2020, ndërsa numri i ankesave teknike është për 1% më i lartë se në vitin 2020.

2.1.5 Konsumatorët e prekur nga presioni i ulët

Ky tregues paraqet numrin mesatar të konsumatorëve të shërbyer gjatë periudhës raportuese të ndodhura në zonat e tyre të shërbimit që në mënyrë të rregullt ballafaqohen me presion më të ulët se niveli minimal i presionit (i përcaktuar të jetë 1.5 bar) tek rubineti i konsumatorit, por që nuk përfshijnë rastet e përkohshme dhe të pashmangshme të presionit të ulët.

**Figura 5.** Përqindja e konsumatorëve të cilat kanë probleme me presion të ulët

Sikurse edhe gjatë vitit paraprak 2020 edhe në vitin 2021, KRU Hidromorava ka raportuar përqindjen më të lartë të konsumatorëve që kanë probleme me sigurimin e presionit në nivelin referent. Probleme me përmbushjen e nivelit të presionit në zonën e shërbimit për vitin 2021 ka raportuar edhe KRU Hidrodrini dhe Hidroregjioni Jugor. Në këto dy regjione është raportuar një numër me i vogël i konsumatorëve që kanë problem me sigurimin e presionit në nivelin referent. Kjo kryesisht është e lidhur me mungesën e

furnizimit të rregullt. Asnjëra nga KRU-të ende nuk kanë të vendosura sisteme të menaxhimit dhe monitorimit të presionit në rrjetin shpërndarës.

Zonat e presioneve nuk janë të ndara në tërë zonën e shërbimit të KRU-ve dhe ende nuk është bërë përditësimi i të dhënave në GIS. Për zvogëlim efektiv të humbjeve të ujit, menaxhimi dhe monitorimi adekuat i presionit është thelbësor, prandaj KRU-të duhet të vendosin sistemin e menaxhimit dhe monitorimit të presionit. Pra, të ndërtohet një model hidraulik plotësisht i monitoruar për të siguruar presionin e minimal në tërë rrjetin shpërndarës të ujit.

2.1.6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Vazhdimësia e furnizimit me ujë paraqet njërin nga standardet e rëndësishëm të shërbimit, përmes të cilit tregohet numri mesatar apo përqindja e pronave në periudhën raportuese që kanë furnizim të vazhdueshëm me ujë. Vazhdimësia e furnizimit me ujë është kategorizuar në tre grupe, prona që kanë furnizim për 23 ose më shumë orë në ditë, prona që kanë 18-23 orë furnizim në ditë dhe pronat që kanë më pak se 18 orë furnizim në ditë, duke përfshirë rastet e veçanta të ndërprerjeve që mund të ndodhin për shkak të problemeve teknike apo ndërprerje të planifikuara të KRU-ve.

Tabela 2. Përqindja e konsumatorëve me furnizim <18 orë, 18-23 orë dhe 24 orë gjatë 2020 dhe 2021

	<18 h furnizim %		18-24 h furnizim %		24 h furnizim %	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021
KRU						
PR	0.6%	0.8%	1.0%	2.2%	98.4%	97.0%
PZ	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	100.0%
PE	0.0%	3.8%	0.8%	0.0%	99.2%	96.2%
MIT	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	100.0%
GJA	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	100.0%
FE	4.1%	3.8%	2.7%	2.5%	93.2%	93.7%
GJI	77.0%	40.7%	16.5%	0.0%	6.5%	59.3%

Kompanitë të cilat gjatë vitit 2021 kanë arritur që ti furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU Mitrovica, KRU Gjakova dhe KRU Hidroregjioni Jugor. Duhet potencuar se e tërë komuna e Mamushës, që është në licencë të shërbimit të KRU Hidroregjioni Jugor, nuk ka fare furnizim me ujë të pijshëm për shkak të problemeve me burimet e ujit.

Më keq për sa i përket këtij standardi qëndron KRU Hidromorava, ku rreth 40% të konsumatorëve kanë furnizim më pak se 18 orë në ditë edhe pse nëse krahasohet gjendja e furnizimit në vitin 2021 me vitin paraprak është shënuar një përmirësim; kjo ka rezultuar për shkak të problemeve më të vogla me thatësi që po mbretëron në këtë regjion. Regres sa i përket këtij treguesi në raport me vitin paraprak ka shënuar KRU Prishtina dhe KRU Hidrodrini gjersa tek KRU Bifurkacioni nuk është raportuar përmirësim i furnizimit të rregullt me ujë në raport me vitin paraprak 2020.




Figura 6. Norma (%) e konsumatorëve me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm

Njëjtë si te treguesi për nivelin e presionit në rrjet, edhe ky tregues është vështirë i matshëm kuantitativisht nga KRU-të dhe i vështirë i monitorueshëm nga ARRU në mungesë të pajisjeve të instaluar në rrjetin shpërndarës të KRU-ve që do të regjistrojnë rrjedhjen apo shtypjen e ujit. Të dy këta tregues bazohen në raportimet nga KRU-të.

2.1.7 Plasaritjet e gypave në rrjetin e ujësjellësit

Ky tregues paraqet numrin total të defekteve/ dëmtimeve të gypave të ujësjellësit gjatë dy viteve në raport me 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit (duke përfshirë dëmtimet në gypat e kyçjeve shtëpiake). Ky tregues mund të jetë reprezentativ për të treguar gjendjen dhe performancën e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit.




Figura 7. Numri i defekteve për 100 km të rrjetit të ujësjellësit

Gjatë vitit 2021 numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km rrjet ka shënuar trend rënës, nga 214 raste të defekteve gjatë vitit 2020, ky numër ka rënë në 204 gjatë vitit 2021.

Në performancën e dobët të rrjetit të ujësjellësit ka ndikuar: vjetërsia e gypave, mungesa e mirëmbajtjes adekuate nga ana e KRU-ve. Numër i madh i defekteve gjatë vitit 2021 është raportuar në KRU Gjakova me 318 raste, kurse KRU Hidromorava ka pasur numrin më të vogël të defekteve të raportuara me vetëm 86 defekte në 100 km rrjet. Ngritje të ndieshme të defekteve në vitin 2021 ka raportuar KRU Bifurkacioni, prej 118 defekteve në vitin 2020, numri i tyre është rritur në 184 në vitin 2021.

2.1.8 Uji i pa-faturuar (uji i humbur)

Edhe në vitin 2021 uji i pa-faturuar (UPF) vazhdon të jetë tejet i lartë dhe mbetet sfida më e madhe me të cilën është duke u përballur sektori i ujit në Kosovë. Për 15 vite me radhë uji i pafaturuar (UPF) shprehur në përqindje për sektorin si tërësi pothuaj nuk ka ndryshuar, është në nivelin 55-61%, me rënie dhe ngritje të vogla nga viti në vit – siç është treguar në figurën 8. Ulje-ngritjet e UPF nga viti në vit dëshmojnë që nuk zbatohen masa adekuate apo aktivitete të mirëfillta nga KRU-të që do të kishin adresuar në mënyrë serioze këtë problem tejet kompleks.




Figura 8. Norma e ujit te pa-faturuar ndër vite (%)

Për KRU-të individuale për vitin 2020 dhe 2021 UPF është dhënë në figurën 9.




Figura 9. Norma e ujit te pa-faturuar (%) gjatë 2021/2020

Përpos paraqitjes së UPF në %, në këtë raport është prezantuar UPF në njësinë [l/konsumatorë për ditë] për sektorin në përgjithësi dhe për KRU individuale për vitin 2020 dhe 2021, që është dhënë në figurën 10.




Figura 10. Uji i pa-faturuar litra për konsumatorë në ditë

Uji i pa-faturuar shprehur në njësinë litër për konsumatorë në ditë është tregues më i përshtatshëm për krahasimin e performancës së KRU-ve, ku në kalkulum është marrë parasysh edhe efekti i furnizimit të kufizuar.

Gjatë vitit 2021 mesatarja e sektorit për ujin e pa-faturuar litra për konsumatorë në ditë kap vlerën prej 575 litra për konsumatorë për ditë, por duhet të potencohet se në vitin 2021 për sektorin ka një ulje të lehtë të UPF [litër për konsumatorë në ditë] krahasuar me vitin paraprak 2020.

KRU Mitrovica ka treguar performancë më të dobët me humbje rreth 1,000 litra për konsumatorë për ditë ndërsa KRU Hidromorava ka performancën më të mirë në këtë tregues me 336 litra humbje për konsumatorë në ditë, më së paku nga të gjitha KRU-të.

Në vitin 2021, nga shtatë KRU, janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët e tyre në total rreth 156.4 milion m³ ujë i pijshëm, që nëse krahasohet me vitin paraprak ka shënuar rritje për 3% te prodhimit. Në nivel sektori norma e UPF ka mbete në të njëjtin nivel prej 55%, gjatë vitit 2021 ne raport me vitin paraprak 2020, mirëpo UPF si vlerë volumetrike gjatë vitit 2021 është më e lartë dhe kap vlerën rreth 86.1 milion m³. Ky vëllim i ujit të pa-faturuar nuk sjellë të ardhura për kompanitë, për më tepër krijon shpenzime si dhe deficite në furnizim të rregullt të popullatës. Nëse këtë vëllim e krahasojmë me vitin 2020 vërejmë një rritje të UPF në vitin 2021 për rreth 1.65 milion m³.

Në tabelën 3 janë përmbledhur të dhënat për UPF, siç është aprovuar dhe të realizuara për vitin 2020 dhe 2021.

Tabelën 3 . Vlerat e UPF të realizuara në raport me objektivat 2020-2021

Kompania	Realizimi		Objektivat	
	2020	2021	2020	2021
KRU Prishtina	58%	58%	48%	48%
KRU Hidroregjioni Jugor	55%	54%	49%	51%
KRU Hidrodrini	60%	58%	53%	55%
KRU Mitrovica	53%	55%	46%	50%
KRU Gjakova	42%	42%	40%	40%
KRU Bifurkacioni	64%	57%	40%	52%
KRU Hidromorava	47%	48%	39%	46%
Mesatarja për sektorin	55%	55%	47%	49%

Asnjë nga KRU-të nuk ka arritur të përmbushë objektivat e planifikuara me procesin tarifar. Në rastin me të mirë KRU Gjakova dhe KRU Hidromorava ishin më afër arritjes së objektivave në vitin 2021, realizimi ishte më i ulët se planifikimi vetëm për 2% te dyja këto kompani.

ARRU gjithnjë ka sugjeruar se për të pasur sukses në uljen e UPF duhet krijuar struktura të qëndrueshme brenda KRU-ve me staf profesional, mjete, teknologji dhe trajnime të nevojshme për të punuar për zvogëlimin e humbjeve dhe për përmbushjen e caceve. UPF është problem shumë kompleks që kërkon një qasje sistematike nga të gjitha nivelet dhe të gjitha departamentet e KRU-ve. Qasja e duhur për të adresuar UPF do të thotë të fillohet nga një pikë ku secili është i vetëdijshëm për shkaqet kryesore dhe përmasat e UPF, dhe në këtë mënyrë, vendos plane dhe caqe të qarta dhe të arritshme për të trajtuar këtë problem. Stafi i ngarkuar me detyrat për reduktimin e UPF duhet të jetë i motivuar dhe i përkushtuar për të punuar dhe të jetë shumë transparent dhe realist gjatë planifikimit dhe kryerjes së punës, dhe mbi të gjitha, përpjekjet për reduktimin e UPF duhet të kuptohen si një proces i vazhdueshëm.

2.1.9 Volumi i ujit të prodhuar, të shitur (faturuar) dhe ujit të humbur

Tabela përmbledhëse për vlerat volumetrike të ujit të prodhuar, ujit të shitur, ujit të humbur, krahasimi i të dhënave të realizuara në vitin 2020 dhe vitin 2021 janë paraqitur në tabelën 4.

KRU-të gjatë procesit tarifar për vitin 2021 i kishin paraqitur projeksionet e tyre për volumen e ujit që do të shesin në mënyrë që t'i furnizojnë konsumatorët e tyre. Për vitin 2021 ishin planifikuar të faturohen rreth 69.92 milion m³ ujë nga të gjitha KRU, përderisa kanë arritur të realizojnë rreth 65.46 milion m³, afërsisht 4.46 milion m³ më pak të realizuara se sa caku. Shprehur në përqindje realizimi kap vlerën prej

rreth 94%, pa marrë parasysh ujin me shumicë që furnizohet për pjesën veriore të Mitrovicës (që është 4,824,515 milion m³).

Përmbushja e caqeve për vëllimin e ujit të shitur (faturuar) për KRU-të dhe mesatarja për sektorin është prezantuar në figurën 11.




Figura 11. Normat volumetrike për ujin e shitur nga KRU në raport me projeksionet sipas planit të biznesit

Emri i KRU	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2020	Aprovuara 2021	Realizuara nga KRU-të 2021	% krahasuese 2021 / 2020	%krahasuese 2021 real/cak
PR	Uji i prodhuar	m ³	52,961,479	49,594,420	55,175,048	104.18%	111.25%
	Uji i humbur	m ³	30,662,482	24,000,000	32,013,675	104.41%	133.39%
	Uji i faturuar	m ³	22,298,997	25,594,420	23,161,373	103.87%	90.49%
	Konsumatorët	Nr	148,510	151,888	153,630	103.45%	101.15%
PZ	Uji i prodhuar	m ³	16,520,232	16,154,385	16,928,504	102.47%	104.79%
	Uji i humbur	m ³	9,137,000	8,238,756	9,209,719	100.80%	111.79%
	Uji i faturuar	m ³	7,383,232	7,915,629	7,718,785	104.54%	97.51%
	Konsumatorët	Nr	52,322	53,122	54,162	103.52%	101.96%
PE	Uji i prodhuar	m ³	24,881,387	23,793,333	24,842,768	99.84%	104.41%
	Uji i humbur	m ³	15,020,430	13,086,333	14,509,230	96.60%	110.87%
	Uji i faturuar	m ³	9,860,957	10,707,000	10,333,538	104.79%	96.51%
	Konsumatorët	Nr	51,154	52,845	53,293	104.18%	100.85%
MIT	Uji i prodhuar	m ³	26,506,027	28,000,000	27,457,562	103.59%	98.06%
	Uji i humbur	m ³	14,065,702	14,000,000	15,156,096	107.75%	108.26%
	Uji i faturuar	m ³	12,440,325	14,000,000	12,301,466	98.88%	87.87%
	Faturimi-Jug	m ³	6,954,809	8,000,000	7,476,951	107.51%	93.46%
	Faturimi-Veri	m ³	5,485,516	6,000,000	4,824,515	87.95%	80.41%
	Konsumatorët	Nr	39,049	43,000	43,935	112.51%	102.17%
GJA	Uji i prodhuar	m ³	15,202,835	15,652,059	15,910,071	104.65%	101.65%
	Uji i humbur	m ³	6,346,777	6,260,823	6,742,405	106.23%	107.69%
	Uji i faturuar	m ³	8,856,058	9,391,236	9,167,666	103.52%	97.62%
	Konsumatorët	Nr	41,851	45,084	43,816	104.70%	97.19%
FE	Uji i prodhuar	m ³	9,494,874	7,860,654	8,258,735	86.98%	105.06%
	Uji i humbur	m ³	6,050,736	4,087,540	4,695,808	77.61%	114.88%
	Uji i faturuar	m ³	3,444,138	3,773,114	3,562,927	103.45%	94.43%
	Konsumatorët	Nr	31,199	33,462	33,569	107.60%	100.32%
GJI	Uji i prodhuar	m ³	6,704,295	8,360,238	7,801,252	116.36%	93.31%
	Uji i humbur	m ³	3,161,125	3,817,787	3,762,981	119.04%	98.56%
	Uji i faturuar	m ³	3,543,170	4,542,451	4,038,271	113.97%	88.90%
	Konsumatorët	Nr	33,553	33,440	34,742	103.54%	103.89%
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	152,271,129	149,415,090	156,373,940	102.69%	104.66%
	Uji i humbur	m ³	84,444,252	73,491,240	86,089,914	101.95%	117.14%
	Uji i faturuar	m ³	67,826,877	75,923,850	70,284,026	103.62%	92.57%
	Konsumatorët	Nr	397,638	412,841	417,147	104.91%	101.04%

Tabela 4. Krahasimi i të dhënave të realizuara dhe aprovuara 2020-2021

Në nivel sektori shitjet volumetrike të realizuara në raport me ato të planifikuara kanë shënuar performancë pothuajse të njëjte nga 93.8% sa ishin gjatë vitit 2020 në 93.6% në vitin 2021. KRU Mitrovica dhe KRU Gjakova kanë arritur të përmbushin shitjet në shkallën 99% dhe 98% përkatësisht, kurse KRU Hidromorava realizimin në raport me planifikimin e ka përmbushur në vlerën 89%.

2.2 PERFORMANCA FINANCIARE – FURNIZIMI ME UJË

Që të dhënat financiare për vitin 2021 të jenë në të njëjtin rrafsh krahasimi me të dhënat e vitit 2020 ato janë përshtatur me normën e inflacionit. Kështu, të dhënat për vitin 2020 të realizuara janë të përshtatura me koeficientin e indeksit të inflacionit 1.03347 përderisa ato të planifikuara janë të rregulluar me koeficientin 1.07435 që paraqet normën e rregulluar (të përshtatur) të inflacionit për periudhën e procesit tarifar 2017-2021.

2.2.1 Vlera monetare e shitjeve (faturimit) (EUR)

Vlera e shitjeve në euro edhe këtë vit për çdo KRU ishte më e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve, kryesisht për shkak të projeksioneve jo të mira të volumeve të shitjeve, siç është prezantuar edhe tek figura 11 (më lartë).





Figura 12. Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Ky mos realizim i volumit të ujit të shitur i ka penalizuar KRU-të për sa i përket gjenerimit të burimeve financiare të nevojshme për të përmbushur planet e tyre të investimeve në infrastrukturën që e menaxhojnë. Pavarësisht këtij dështimi, për të përmbushur caqet e shitjeve, vlera absolute e shitjeve është rritur, kjo kryesisht i atribuohet rritjes së tarifave në vitin 2021 dhe 2020.

Tabela 5. Vlera e shitjeve të realizuara dhe planifikuara 2020-2021

Vlera e shitjeve (Euro)							
2020				2021			Raporti:
KRU	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	realizimi 2021/realizimi 2020
PR	15,140,109	12,980,170	86%	14,670,957	12,926,586	88%	-0.41%
PZ	4,544,793	3,939,293	87%	4,167,400	3,964,962	95%	0.65%
PE	3,658,966	3,510,499	96%	3,721,959	3,517,253	95%	0.19%
MIT	2,738,222	3,265,736	119%	3,347,663	3,325,071	99%	1.82%
GJA	4,226,645	4,057,953	96%	4,300,408	4,194,101	98%	3.36%
FE	2,087,177	1,750,566	84%	1,836,891	1,779,260	97%	1.64%
GJI	1,807,144	1,768,531	98%	2,106,189	1,924,245	91%	8.80%
Sektori	34,203,055	31,272,749	91%	34,151,467	31,631,479	93%	1.15%

Vlera e shitjeve të ujit të realizuara në vitin 2021 në nivel të sektorit ishin 31.6 milion €, ndërsa shitjet e planifikuara kanë qenë rreth 34,15 milion €, që do të thotë se caku është pëmbushur në masën 93%. Për sa i përket këtij treguesi vërehet një rritje vetëm për 1.15% në krahasim me vitin 2020, rritje pothuaj e papërfillshme.

**Figura 13.** Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2021 në raport me vitin 2020

Nga shtatë KRU-të, gjashtë prej tyre kanë treguar progres tek shitjet gjatë periudhës raportuese 2021 në raport me vitin 2020, KRU Prishtina ka pasur një ulje prej 0.4% krahasuar me vitin 2020.

Në vitin 2021 KRU Hidromorava kishte ngjeshjen më të lartë të shitjes së ujit krahasuar me planifikimin, kishte arritë të përmbushte cakun në masën 89%. Në anën tjetër KRU Hidromorava kishte arritur të tejkalonte shitjet krahasuar me vitin 2020 për 8.8%. Ky është kryesisht rezultat i rritjes së volumit të ujit të prodhuar për 16% krahasuar me vitin paraprak (për shkak të thatësisë që kishte mbretëruar në vitin 2020), e që ishte reflektuar me rritje të shitjeve të ujit për 14% krahasuar me vitin 2020.

2.2.2 Kostot për njësi

Kostot për njësi përfshijnë: koston operative për njësi të ujit të prodhuar, koston totale operative për njësi të ujit të prodhuar dhe koston totale për njësi të ujit të shitur që janë prezentuar në tabelën 6.

Tabela 6. Kostot për njësi për vitet 2020 dhe 2021

KRU	2020			2021		
	Kosto operative për njësi e ujit të prodhuar	Kosto totale operative për njësi e ujit të prodhuar	Kosto për njësi e ujit të shitur	Kosto operative për njësi e ujit të prodhuar	Kosto totale operative për njësi e ujit të prodhuar	Kosto për njësi e ujit të shitur
PR	0.049	0.059	0.484	0.046	0.055	0.453
PZ	0.099	0.102	0.416	0.105	0.108	0.414
PE	0.005	0.006	0.233	0.014	0.015	0.264
MIT	0.068	0.069	0.384	0.055	0.056	0.317
GJA	0.026	0.034	0.461	0.024	0.032	0.412
FE	0.041	0.042	0.398	0.043	0.045	0.367
GJI	0.093	0.097	0.423	0.074	0.078	0.414
Sektori	0.050	0.055	0.414	0.048	0.053	0.390

2.2.3 Kostoja operative për njësi e ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues i rëndësishëm financiar në bazë të cilës kuptojmë shpenzimet për një (1) m³ të ujit të prodhuar dhe paraqet koston totale të prodhimit të ujit në periudhën raportuese pjesuar me volumin e ujit të prodhuar për të njëjtën periudhë.




Figura 14. Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë vitit 2021 dhe 2020

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie të ujit të prodhuar, në terma reale financiare ka shënuar rënie të lehtë nga 0.05 €/m³ sa ishte në vitin 2020 në 0.048 €/m³ për vitin 2021.

Kostot e prodhimit të ujit dallojnë nga 0.014€/m³ tek KRU Hidrodrini, deri tek ajo me e larta në 0.11€/m³ në KRU Hidroregjioni Jugor. Kjo për arsye të llojit të sistemeve të furnizimit me ujë që menaxhojnë KRU-

të. KRU Hidrodrini ka shpenzime më të ulëta të trajtimit të ujit dhe të energjisë, numër më të vogël të burimeve të ujit në shfrytëzim, e uji kryesisht transportohet tek konsumatorët përmes gravitetit.

Kostoja e lartë e ujit të prodhuar tek KRU Hidroregjioni Jugor, edhe këtë vit sikurse vitet e kaluara, është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit, e në veçanti nga shpenzimet e larta të energjisë duke qenë se operon me mbi 40 burime (sisteme të ndryshme), e shumica dërmuese e tyre bazohet në pompim të ujit; shpenzimet e energjisë dhe derivateve marrin pjesë me 40% në shpenzimet totale të ujit të prodhuar.

Edhe pse kostot operative për njësi në shiqim të parë duken të ulëta në krahasim me tarifat për shërbimet e ujit për secilën KRU, duhet pasur parasysh nivelin e lartë të humbjeve që së bashku me efikasitetin e dobët në arkëtimin e të ardhurave rrisin dukshëm koston e ujit të shitur, përafërsisht duhen rreth 2.3 m³ të ujit të prodhuar për të gjeneruar 1 m³ të ujit të shitur dhe të paguar.

2.2.4 Kostoja për njësi të ujit të shitur

Kostoja totale për njësi për aktivitetet e furnizimit me ujë (kostot operative plus mirëmbajtja kapitale, por duke përfshirë kthimin në kapital dhe borxhet e këqija²), e rregulluar më normë të inflacionit, është paraqitur në figurën 15.




Figura 15. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë (€ për m³ ujë të shitur)

Në vitin 2021 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 0.39 € për m³ që është për 0.02 € për m³ më e ulët se në vitin 2020.

Siç vërehet nga figura 15 ekziston një diversitet i gjerë sa i përket koston për njësi të ujit të shitur, prej KRU Hidrodrini që ka nivel dukshëm më të ulët të koston në krahasim me të gjitha kompanitë tjera të ujit më 0.26 €/m³ deri tek ajo me e lartë për KRU Prishtina më 0.45 €/m³ të ujit të shitur.

Ulje të koston për njësi të ujit të shitur vërehet tek KRU Mitrovica nga 0.38 €/m³ sa ishte në vitin 2020 në 0.32 €/m³ për vitin 2021, që është rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve operative për shërbimet e ujësjellësit dhe rritjes së shitjeve volumetrike të ujit.

² Në përputhje me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit borxhet e këqija në këtë raport janë të definuara si shuma e të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

2.2.5 Kostoja njësi e ujit të shitur e realizuar në raport me atë të planifikuar

Kostoja njësi e ujit të shitur është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të cilëve matet performanca e furnizimit me ujë.

Në figurën 16 është paraqitur kostoja e realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale pjesëtuar për faturimin në m³) në raport me koston e planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale pjesëtuar për faturimin në m³).




Figura 16. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Në nivel të sektorit përmbushja e planifikimit për koston njësi të shitjes së ujit në vitin 2021 është përafëruar në nivelin prej 90% dhe krahasuar me vitin paraprak ajo është përmiresuar për 4%; nga 95% sa ka qenë ka rënë në 91%.

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi në shumicën e KRU-ve ishin nën nivelin prej 90%, megjithatë edhe kjo nuk tregon një performancë shumë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukture dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që këto kompani nuk kanë arritur ti realizojnë ato as 50% të tyre.

Ajo se çfarë nënkuptohet me këtë është se edhe pse kostot për njësi në përgjithësi ishin më të ulëta se sa ishin planifikuar kjo rezultoi me përkeqësimin e gjendjes së aseteve dhe rënien e nivelit të shërbimeve.

2.2.6 Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Procesi tarifar 2018 – 2021 (më konkretisht ai i vitit 2021) kishte përfshirë provizionime për shpenzime kapitale për mirëmbajtje kapitale po ashtu edhe për rritje/ ripërtëritje kapitale. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve, sidomos e atyre për mirëmbajtje kapitale, pritej se do të financoheshin nga burimet e veta financiare të KRU-ve, por siç shihet, realizimi është i ulët. ARRU është tejet e shqetësuar me nivelin e zbatimit të projekteve kapitale, të cilat veçse kanë qenë të përfshira në tarifa. ARRU vlerëson se KRU-të ende nuk bëjnë dallimin në mes shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale dhe shpenzimeve për rritje/ përtëritje kapitale. Nga vëzhgimet e ARRU-së pothuajse të gjitha shpenzimet kapitale kanë qenë të dedikuara në zgjerimin kapital, e me pak ose aspak shpenzime për mirëmbajtje kapitale, fakt që rezulton me përkeqësim të gjendjes së aseteve dhe rënie të nivelit të shërbimit.

Në tabelën 7 janë prezantuar vlerat e planifikuara dhe të realizuara të investimeve kapitale nga burimet vetanake të KRU-ve dhe nga grantet.

Tabela 7. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake për vitet 2020 dhe 2021

	Burimet vetanake të investimit				
	2020	2021			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020 (realizim)
PR	104,013	1,213,475	497,374	41.0%	378%
PZ	362,961	617,509	181,310	29.4%	-50%
PE	379,290	633,865	242,803	38.3%	-36%
MIT	-	376,258	227,145	60.4%	/
GJA	1,548,951	420,186	296,833	70.6%	-81%
FE	13,474	317,867	7,464	2.3%	-45%
GJI	62,864	342,287	25,559	7.5%	-59%
Spektori	2,471,553	3,921,446	1,478,488	37.7%	-40%

Në nivel të sektorit për vitin 2021 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzojnë rreth 3.92 milion Euro të cilat janë përfshirë në tarifat e aprovuara, cak ky i cili është realizuar në nivelin prej 37.7%. Për nga lartësia e investimeve vetanake prinë KRU Prishtina me 41.2% të realizimit të cakt, kurse KRU Bifurkacioni ka përmbyshë cakun vetëm 2.3%.

Tabela 8. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet për vitet 2020 dhe 2021


	Investimet prej granteve				
	2020	2021			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020 (realizim)
PR	84,521	1,289,216	30,210	2.3%	-64%
PZ	2,300,583	24,297,171	135,902	0.6%	-94%
PE	0	0	0	/	/
MIT	250,320	689,495	161,178	23.4%	-36%
GJA	1,340,079	13,653,382	22,778	0.2%	-98%
FE	1,364	1,912,338	0	0.0%	-100%
GJI	200,704	0	0	/	-100%
Spektori	4,177,571	41,841,602	350,068	0.8%	-92%

Investimet e planifikuara prej donacioneve/ granteve janë realizuar në nivelin 0.8%, përkundër që pritjet kanë qenë tepër të larta. Tek kjo kategori e investimeve shihet se vetëm KRU Mitrovica ka qenë pak më objektive në planifikim, përmbyshja e cakt është arritë të jetë 23.4%, KRU Hidrodrini dhe Hidromorava nuk kanë planifikuar investime nga grantet, ndërsa katër KRU-të tjera kanë mbetur shumë larg pritjeve për investime nga grantet.

Tabela 9. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitet 2020 dhe 2021

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2020	2021			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020
Sektori-InvVet	2,471,553	3,921,446	1,478,488	37.70%	-40%
Sektori-Grant	4,177,571	41,841,602	350,068	0.8%	-92%
Sektori	6,649,124	45,763,048	1,828,556	4.00%	-72%

Vlera e kombinuar e investimeve në infrastrukturën e ujit nga financimi vetanak dhe nga grantet në vitin 2021 arrinë në 1.82 milion Euro, shumë e pamjaftueshme për të mirëmbajtur në gjendje të mirë operative infrastrukturën që e menaxhojnë, ndërsa përmbushja e caktuar arrin vetëm 4%.

**Figura 17.** Shpenzimet kapitale të realizuara nga të hyrat vetanake dhe grantet për furnizim me ujësjellës në raport me planin

Shpenzimet për investimet kapitale të realizuara në të gjitha KRU-të ishin më të ulëta se niveli i pritur; përmbushja e investimeve ishte më e ulëta tek KRU Bifurkacioni në nivelin prej vetëm 0.3%, ndërsa ishte më e larta të KRU Hidrodrini me nivel të përmbushjes të caktuar prej 38.3%, ndërsa mesatarja për sektorin është 4.0%.

Kjo përqindje është sipas gjendjes së pasqyrave të kontabilitetit të datës 31.12.2021. Duhet potencuar se një numër i projekteve kapitale të përfshira në tarifa kanë qenë në ekzekutim e sipër edhe gjatë vitit 2022 të cilat nuk janë përfshirë në këto shifra. Për një pjesë tjetër të projekteve ka pasur shtyerje të zbatimit ose anulim të projekteve për shkak të mungesës së Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për më shumë se dy (2) vite.

KRU Prishtina prinë me realizimin e shpenzimeve kapitale (investime vetanake dhe grante) në vlerë prej 527,584 mijë euro prej të cilave pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë realizuar në prodhim dhe atë në rritje të infrastrukturës, kryesisht në shpronësim të tokave dhe në hapje të puseve.

KRU Mitrovica në raport me kompanitë tjera ka realizuar investime në shumën prej 388 mijë euro ku 99% të tyre i ka realizuar në rritje të jo-infrastrukturës në aktivitetin biznesor dhe atë në ndërtim të objektit të ri dhe në inventar.

KRU Hidroregjioni Jugor ka patur pritje të bëhen investime të konsiderueshme në projektet e ndërtimit dhe rehabilitimet të rrjetit të ujësjellësit, por që këto dështime i atribuohen mos realizimit të donacioneve të planifikuara në Biznes Planin e tyre për vitin 2021.

Kompania Bifurkacioni tash e sa vite mbetet kompania e cila realizon me se paku investime dhe në raport me projektet e planifikuara ka përmbushur objektivin vetëm me 0.3%.

2.3 PERFORMANCA OPERATIVE – SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.3.1 Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Aktualisht mbulimi me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura në vend është shumë i ulët. Në vitin 2021 ka hyrë në funksion ITUN në Prizren dhe Pejë, ndërsa pritet që në një të ardhme të afërt të futet në operim edhe ITUN në Gjakovë. Këto tre impiante, përfshirë edhe impiantin në Skenderaj që veçse ka qenë në operim më herët, në total trajtojnë ujërat e ndotura të shkarkuara nga vetëm 3.5% e popullatës që kanë qasje në kanalizimin publik të menaxhuar nga KRU-të e licencuara dhe 11% nga tërë vëllimi i ujërave të ndotura të faturuar konsumatorëve. Kompanitë kanë raportuar se trajtimi i ujërave të ndotura dhe shkarkimi i tyre është brenda standardeve të lejuar vendore. Vlen të përmendet se në kuadër të ITUN, janë ndërtuar laboratorë modern të pajisur me aparatura mjaftë të mira. Duke qenë se ITUN vetëm sa janë futur në funksion, raportimi për kualitetin e ujërave të ndotur të shkarkuar në mjedisin rrethues (efluentit) nuk është vendosur ende.

2.3.2 Shpeshtësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit

Ky tregues paraqet numrin i rasteve të bllokimit të kanalizimit të raportuara nga KRU (ose të identifikuar nga personeli i KRU) në periudhën raportuese për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit. Në këtë kategori nuk përfshihen bllokimet në infrastrukturën brenda pronës së konsumatorëve.




Figura 18. Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Gjatë vitit 2021 KRU Gjakova, KRU Mitrovica dhe KRU Hidroregjioni Jugor kanë shënuar rritje të numrit të rasteve të bllokimeve për 100 kilometra të rrjetit të kanalizimit. Në nivel sektori numri i bllokimeve për 100 kilometra ka shënuar rënie të ndjeshme nga 617 raste sa ishin në vitin 2020 në 512 raste gjatë vitit 2021. Kompania e cila ka raportuar më së shumti të dhëna sa i përket bllokimit të kanalizimit gjatë vitit 2021 është KRU Gjakova me 1,127 raste të bllokimeve, e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2020 ka pas rritje të rasteve të raportuara për 16%.

Ky numër kaq i lartë i bllokimeve është një tregues edhe i gjendjes reale të rrjetit të kanalizimit. KRU-të duhet t'i kushtojnë rëndësi investimeve në infrastrukturën e kanalizimit, pasi siç duket ky sektor ka mbetur pas dore duke i dhënë prioritet më të lartë infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm.

2.3.3 Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është definuar si përqindje e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura (kanalizim) gjatë periudhës së raportimit. Mbulueshmëria me shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura në vitin 2021 është rreth 65% të popullatës dhe nëse krahasohet me vitin paraprak 2020 ka mbetur në pozitën e njëjtë. Duhet potencuar se përqindja i referohet vetëm sistemeve të menaxhuara nga KRU-të. Ka sisteme të tjera të grumbullimit të ujërave të ndotura që nuk janë përfshirë në këtë përqindje dhe që operohen nga komuniteti apo komunat përkatëse.




Figura 19. Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura (%)

Gjatë inspektimit tek KRU-të është vërejtur dukuria e menaxhimit të një numri të sistemeve të kanalizimit, të cilat pranojnë shërbimet e mirëmbajtjes por nuk faturohen. Me qëllim të eliminimit të kësaj dukurie, ARRU rekomandon që KRU-të të negocijojnë dhe të nënshkruajnë marrëveshjet për shërbim me komunat përkatëse për marrjen në menaxhim të këtyre sistemeve.

Edhe gjatë vitit 2021, sipas informacioneve të KRU dhe akterëve tjerë të sektorit të ujit, ekzistonë një numër i sistemeve të kanalizimit të cilat ende nuk menaxhohen nga KRU-të.

2.3.4 Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin se sa janë të kënaqur konsumatorët me kualitetin e shërbimeve të ujërave të ndotur që ofrohen nga KRU-të. Në tabelën xxx janë prezantuar ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujërave të ndotur.

Në total gjatë vitit 2021, numri i ankesave për shërbimet e ujërave të ndotura arrin në 7,762 prej të cilave të gjitha ankesat janë të natyrës teknike. Ky numër i ankesave paraqet rritje për 24% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 10. Ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura

KRU	Ankesat teknike		Ankesat komerciale		Raporti krahasues: 2021/2020
	2020	2021	2020	2021	
PR	2,670	4,047	0	0	52%
MIT	1,623	2,972	0	0	83%
PE	1,342	52	0	0	-96%
PZ	576	658	0	0	14%
GJA	39	0	0	0	-100%
GJI	18	33	0	0	83%
FE	3	0	0	0	-100%
Spektori	6,271	7,762	0	0	24%

Numri më i madh i ankesave gjatë vitit 2021 për shërbimin e ujërave të ndotura është paraqitur nga KRU Prishtina me gjithsej 4,047 ankesa, ndërsa kompanitë të cilat nuk kanë prezantuar fare ankesa në shërbimet e ujërave të ndotura janë KRU Bifurkacioni dhe KRU Gjakova.

Ankesat në këtë shërbim kryesisht kanë qenë në lidhje me bllokimet e kanalizimeve, rastet e përmytjeve dhe kërkesave për pastrim të kanalizimit.

2.4 PERFORMANCA FINANCIARE – SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.4.1 Vlera e planifikuar e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro)

Vlera e shitjeve për shërbimet e ujërave të zeza drejtpërdrejt është e lidhur me volumet e shitjeve të ujit. Për shkak të performancës së dobët të shitjeve të realizuara të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, e njëjta performancë e dobët është reflektuar edhe te shitjet e realizuara të shërbimeve të ujërave të ndotura, siç është prezantuar në figurën 20.




Figura 20. Shitjet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Pavarësisht se nuk janë arritur caqet e shitjeve tek disa kompani, të ardhurat nga shitjet për shërbimet e ujërave të ndotura në terma real aktualisht janë rritur për 4%, e cila më shumë mund ti përshkruhet rritjes së tarifave se sa përmirësimit të performancës komerciale për shkak të ndonjë aktiviteti specifik të ndërmarrë nga KRU-të.

KRU Hidrodrini, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni dhe KRU Prishtina i kanë tejkaluar objektivat e planifikuara; Hidrodrini për 10%, Hidromorava për 9%, Bifurkacioni për 9% dhe Prishtina për 1%. KRU-të tjera nuk kanë arritur të përmbushin objektivat për shitje të ujërave të ndotur, e më së keqi në këtë aspekt qëndron KRU Hidroregjioni Jugor që ka përmbushur planifikimin në nivelin 83%, që ka qenë 5% më ulët se sa në vitin 2020.

2.4.2 Vlera e realizuar e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura (Euro)

Trendi i vlerës së shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese 2021 në raport me vitin 2020 në nivel sektori ka shënuar rritje prej 12%. Siç është prezantuar në figurën 21, KRU Hidroregjioni Jugor ka realizuar rritjen më të lartë të shitjeve krahasuar me shitjet e vitit 2020 për 60.4%, KRU Hidromorava për 12.7% dhe KRU Prishtina me 6.9%. Shtimi i shitjeve për shërbimet e ujërave të ndotur në KRU Hidroregjioni Jugor i atribuohet kryesisht rritjes së tarifave për këtë shërbim, po edhe rritjes së bazës së konsumatorëve.

Shitjet në vitin 2021 kanë qenë më të ulëta se në vitin 2020 tek KRU Mitrovica për 0.3% dhe tek KRU Bifurkacioni për 13.6%. Ky zvogëlim, në veçanti për KRU Bifurkacioni, vjen si rezultat i zvogëlimit të tarifës për grumbullim të ujërave të ndotura.




Figura 21. Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2021 në raport me vitin 2020

2.4.3 Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore Kosto totale e (provizionimit e shp. operative + mirëmbajtjes kapitale) për grumbullimin e ujërave të ndotura në periudhën raportuese pjestuar me numrin mesatar të amvisërive dhe ekuivalentëve të amvisërive në të njëjtën periudhë duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale për konsumatorët shtëpiak të shërbyer³.

Kostot për njësi për vitin 2020 dhe 2021 janë të paraqitura në figurën 22. Këto kosto për njësi janë shumë të ulëta, kryesisht për shkak të faktit se nuk ka shpenzime të trajtimit, përjashtuar KRU Hidoregjioni Jugor, që ka filluar me këtë shërbim. Për më tepër, duke mos investuar në mirëmbajtje kapitale në rrjet në periudhën raportuese këto shpenzime janë më të ulëta se sa që do të pritej të ishin.

³ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definoen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.




Figura 22. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura

Kostoja mesatare për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura në 2021 ka treguar rënie të lehtë krahasuar me vitin 2020, nga 6.52 euro/konsumatorë*vit në 6.41 euro/konsumatorë*vit.

Koston më të ulët e ka KRU Prishtina që është 2.62 Euro/konsumatorë në vit, për shkak të tarifës tejte të ulët për ujërat e ndotur. Në anën tjetër KRU Hidroregjioni ka pasur koston më të lartë për shkak të futjes në operim të impiantit të ujërave të ndotur. Në vitin 2021 kostoja vjetore për shërbimet e ujërave të zeza që i ngarkohet një konsumatori shtëpiak është afërsisht sa 1/10 e koston për furnizim me ujë tëpijshëm.

2.4.4 Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar në raport me atë të planifikuar

Është tregues tjetër financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, dhe si i tillë ka ndikim në performancën e shërbimeve të ujërave të ndotura.

Ky tregues paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak) dhe koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).




Figura 23. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(%)

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 4 (2018-2021) konkretisht për vitin 2021 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2017), në të gjitha kompanitë ishin më të ulëta se ato të planifikuara.

Edhe pse kompanitë kanë arritur pothuajse nivelin e dëshiruar me të ulët se 90%, kjo nuk është një performancë e mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukture dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që këto kompani nuk kanë arritur ti realizojnë ato as 6% të tyre.

2.4.5 Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Sikurse për infrastrukturën e ujit gjatë procesit tarifor 2018-2021 (konkretisht për vitin 2021) janë aprovuar investime nga burimet vetanake të KRU-ve edhe për infrastrukturën e ujërave të ndotur, të cilat janë përfshirë në tarifa. Nga ana tjetër KRU-të kanë prezantuar edhe projeksionet-planifikimet e tyre për investime edhe nga grantet. Siç mund të shihet nga tabelat 11, 12 dhe 13 investimet në infrastrukturën e ujërave të ndotur janë shumë të vogla, si nga burimet vetanake ashtu edhe nga grantet. Kjo mund të qojë shumë shpejtë në degradimin e infrastrukturës së ujërave të ndotur, e cila edhe ashtu është në gjendje të rënduar.

Tabela 11. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake për vitet 2020 dhe 2021

	Burimet vetanake të investimit				
	2020	2021			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020
PR	574	532,201	21,754	4.1%	3690%
PZ	9,551	199,829	2,275	1.1%	-76%
PE	4,761	107,435	11,859	11.0%	149%
MIT	-	117,671	22,139	18.8%	
GJA	14,384	124,048	3,885	3.1%	-73%
FE	3,102	123,550	1,415	1.1%	-54%
GJI	112	115,823	414	0.4%	270%
Sektori	32,485	1,320,557	63,741	4.8%	96%

Nga tabela 11 vërehet se investimet e planifikuara nga investimet vetanake për vitin 2021 janë realizuar në masën 4.8%. E tërë vlera monetare e investimeve kapitale (rritje dhe mirëmbajtje kapitale) në infrastrukturën e ujërave të ndotur është 63,741 Euro.

Tabela 12. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet për vitet 2020 dhe 2021

	Investimet prej granteve				
	2020	2021			
KRU	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020
PR	0	0	979,931	/	/
PZ	270,300	19,579,974	0	0.0%	-100%
PE	414,265	20,412,593	0	0.0%	-100%
MIT	0	0	15,941	/	/
GJA	0	5,525,700	529	0.0%	/
FE	341	322,304	0	0.0%	-100%
GJI	0	0	0	/	/
Sektori	684,907	45,840,571	996,401	2.2%	45%

Edhe investimet nga grantet për vitin 2021 nuk janë të larta krahasuar me planifikimin, caku është realizuar në masën 2.2%. Vlen të përmendet një investim substancial i kryer nga KRU Prishtina në vlerë prej 979,931 Euro dhe KRU Mitrovica në vlerë prej 15,941 Euro, që nuk ka qenë fare të planifikuara. KRU-të tjera nuk kanë realizuar asnjë projekt nga grantet.

Tabela 13. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitet 2020 dhe 2021

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2020	2021			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2021: realizim/planifikim	% krahasuese: 2021/2020
Sektori-InvVet	32,485	1,320,557	63,741	4.8%	96%
Sektori-Grant	684,907	45,840,571	996,401	2.2%	45%
Total Sektori	717,392	47,161,128	1,060,142	2.2%	48%

ARRU pret nga KRU-të që planifikimet në të ardhmen të jenë me realiste. Sikurse për furnizimin me ujë ne presim plane për të ardhmen të cilat do të sigurojnë investime adekuate në sektorin e ujërave të ndotura për të siguruar nivele të kënaqshme të shërbimit, e në veçanti përmirësim të mbulueshmërisë me shërbime duke qenë se mbulueshmëria është shumë e ulët.

KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Hidrodrini, dhe KRU Gjakova janë ndër kompanitë që kanë planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura: rehabilitim të rrjetit, në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, montimin dhe sigurimin e kapakëve për puseta të kanalizimit fekal, etj., e që realisht nga këto kompani nuk është arritur të realizohet as 1% e tyre.

Realizimi i investimeve nga burimet vetanake dhe nga grantet në infrastrukturën e ujërave të ndotur është paraqitur në figurën 24.




Figura 24. Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planifikimet

2.5 PERFORMANCA E PERGJITHSHME FINANCIARE E KRU

2.5.1 Arkëtimi i të ardhurave për shërbimet e ujit (ujë i pijshëm dhe ujëra të ndotur)

Në kapitullin në vijim është paraqitur performanca e kompanive për disa tregues të përgjithshëm financiar për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotur për vitin 2021 dhe është krahasuar me vitin 2020. Të dhënat janë paraqitur si raport i arkëtimit të keshit ndaj faturimit të rregullt për shërbimet e ofruara të ujësllësit dhe ujërave të ndotura, duke përfshirë taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera operative. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Figura 25. Arkëtimi i keshit

Në vitin 2021 efijencia e arkëtimit të keshit nga faturat e shërbimeve është përmirësuar dukshëm; në nivel sektori shkalla e arkëtimit është realizuar në masën prej 96%, që është për 12% më e lartë se sa në vitin 2020. Rritja e shkallës së arkëtimit është e evidente në të gjitha KRU-të. KRU Hidrodrini prinë me shkallën më të lartë të arkëtimit në raport me kompanitë e tjera dhe atë në përqindje prej 129%, e njëherit edhe me përmirësimin më të lartë, rezultat i të cilës rritje ishte kryesisht arkëtimi i faturave të papaguara (nga vitet paraprake) prej konsumatorëve komercial dhe atë në përqindjen prej 267%.

KRU Mitrovica mbetet me shkallën më të ulët të arkëtimit në raport me kompanitë e tjera, përderisa në raport me vitin paraprak ka treguar përmirësim prej 6%.

Caku i planifikuar i arkëtimit me procesin tarifor për vitin 2021 në nivel të sektorit ka qenë 92%, përderisa ky cak në nivel të sektorit për vitin 2021 është tejkaluar për 4%. Caqet e aprovuara nga ARRU edhe në nivel individual janë arritur në shumicën e kompanive në përjashtim të KRU Prishtina, KRU Mitrovica dhe KRU Bifurkacioni të cilat ende mbesin larg objektivave të planifikuara.

Tabela 14. Shkalla e arkëtimit e realizuar dhe e planifikuar për vitet 2020 dhe 2021

Shkalla e arkëtimit	Realizuar		Objektiva	
	2020	2021	2020	2021
KRU				
PR	83%	91%	95%	94%
PZ	93%	100%	94%	94%
PE	80%	129%	90%	94%
MIT	68%	74%	80%	79%
GJA	95%	103%	93%	93%
FE	73%	80%	90%	93%
GJI	86%	92%	92%	93%
Spektori	84%	96%	92%	92%

Në tabelën 14 është prezantuar arkëtimi sipas KRU-ve individuale, ndërsa në tabelën 15 janë prezantuar të dhënat për shkallën e arkëtimit sipas KRU-ve individuale për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Tabela 15. Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2020-2021

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Amvisëri	81%	87%	89%	100%	77%	93%	63%	74%	93%	107%	70%	80%	81%	91%
Kom.-industrial	85%	104%	97%	96%	80%	267%	84%	81%	93%	101%	82%	93%	111%	92%
Institucione	95%	97%	119%	108%	98%	107%	109%	66%	113%	84%	99%	42%	87%	100%
Mesatarja	83%	91%	93%	100%	80%	129%	68%	74%	95%	103%	73%	80%	86%	92%

Siç shihet nga tabela 15, KRU-të kanë probleme me arkëtim tek kategoria e konsumatorëve shtëpiak dhe ata komercial-industrial, por në përgjithësi ka përmirësim krahasuar me vitin paraprak. Kategoria më e rregullt e konsumatorëve për pagesë janë ata institucional, përveç rastit tek KRU Bifurkacioni, të cilët kanë probleme me vjeljen e keshit prej institucioneve. KRU Bifurkacioni duhet të komunikojë me këtë kategori të konsumatorëve për të gjetur zgjidhje për pagesë.

2.5.2 Kthimi në kapital

Kthimi në Kapital është tregues krahasues i performancës së menaxhimit financiar dhe i lejimeve të vlerës kthyesë të kapitalit gjatë rishqyrtimit tarifar. Ky tregues paraqet të hyrat totale neto prej aktiviteteve operative para interesit, dividendës dhe taksës korporative pjesuar për bazën rregullatore të asteve (BRRA) gjatë periudhës raportuese. Konform metodologjisë tarifore, ARRU në procesin tarifar 2018-2021 ka aprovuar një normë të kthimit në kapital në vlerën prej min. 4% të bazës rregullatore të aseteve, pra një normë reale të kthimit në kapital e cila është e bazuar në praktikën e mira të vendeve të Evropës.

Nëse krahasohet të dhënat për këtë tregues, kthimi në kapital në nivel të sektorit ka treguar trend negativ krahasuar me vitin paraprak nga 4.64% sa ishte në vitin 2020 në 2.36% për vitin 2021.




Figura 26. Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)

Në vitin 2021 vetëm një nga 7 KRU-të ka arritur të këtë trend pozitiv të kthimit në kapital në raport me vitin 2020, duke tejkaluar madje nivelin e planifikuar prej 4%. KRU Hidroregjioni ka arritur jo vetëm ti mbulojë shpenzimet e tyre operative, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukture në BRRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre, ajo njëkohësisht ka pasur mundësinë të bëjë investime kapitale nga të hyrat vetanake.

Performancën më të dobët tek norma e kthimit në kapital për vitin 2021 në raport me kompanitë e tjera e ka KRU Mitrovica me 0.04%, përderisa përkeqësimin më të lartë në vitin 2021 në raport me vitin 2020 e ka pasur KRU Hidrodrini dhe KRU Bifurkacioni.

2.5.3 Shpenzimet operative

A) Shpenzimet operative në nivel sektori

Shpenzimet e operative të përgjithshme (për ujë të pijshëm dhe ujëra të ndotura) të paraqitura në tabelën 15 pasqyrojnë shpenzimet e realizuara dhe të planifikuara për vitin 2020 dhe 2021.

Tabela 16. Vlera e shpenzimeve operative të realizuara dhe planifikuara

Shpenzimet operative	Realizimi			Planifikimi	
	2020 pa inflac.	2020 me inflac.	2021	2020	2021
KRU					
PR	10,099,460	10,437,540	10,254,011	11,315,023	11,414,297
PZ	3,886,757	4,016,867	3,872,999	4,014,712	4,600,203
PE	2,561,795	2,647,551	2,903,742	2,827,663	3,035,030
MIT	3,535,423	3,653,772	3,363,490	2,708,147	3,576,403
GJA	3,697,304	3,821,071	3,642,510	3,347,488	3,815,598
FE	1,535,549	1,586,952	1,517,169	1,994,011	1,690,353
GJI	1,848,835	1,910,725	1,784,596	2,222,125	1,940,286
Sektori	27,165,122⁴	28,074,478⁵	27,338,517	28,429,170	30,072,171

⁴ Shpenzimet operative pa përfshirjen e inflacionit.

⁵ Shpenzimet operative me përfshirjen e inflacionit.

Siç e shohim edhe nga tabela 16 në vitin 2021 për 7 (shtatë) KRU janë aprovuar nga ARRU rreth 30.1 milion euro shpenzime operative dhe nga kjo shumë janë realizuar 27.3 milion euro. Që do të thotë se këto kompani kanë arritë që shpenzimet e realizuara në raport me planin ti kenë nën nivelin prej 100% (nga 84% të KRU Hidroregjioni Jugor deri tek KRU Hidrodrini me 96%).

B) Struktura e shpenzimeve operative

Kontrollimi i kostove operative është shumë kritike në ofrimin e shërbimeve. Shpenzimet e mëdha për personelin dhe energji të cilat në vitin 2020 për KRU ishin 79%, (nga totali i shpenzimeve) dhe tani 80% në vitin 2021 janë shpenzime që kanë ndikuar esencialisht në efikasitetin e KRU.

Normën më të lartë në strukturën e shpenzimeve operative tek kompanitë e ujit e përbëjnë shpenzimet për personelin dhe atë për 61% në vitin 2021, e cila ka mbete në nivel të njëjtë me vitin paraprak 2020 por që kanë tejkaluar shpenzimet e planifikuara për 1%.

KRU Bifurkacioni dhe Hidromorava në raport me kompanitë e tjera kanë shpenzimet më të larta për personel të cilat për vitin 2021 kanë pjesëmarrjen 77% tek Bifurkacioni dhe 70% tek Hidromorava, përderisa përqindjen me të ulët në këtë kategori e ka KRU Prishtina me 54% me një rënie prej 3% krahasuar me vitin 2020.

Kategoria e dytë kryesore e shpenzimeve është energjia, që në mesataren e sektorit për vitin 2021 merr pjesë me 19% dhe ka treguar trend rritës për 1% në raport me vitin 2020.

Për sa i përket shpenzimeve të energjisë KRU Hidroregjioni Jugor tash e sa vite prinë me përqindjen më të lartë të kësaj kategorie të shpenzimeve që merr pjesë me 23% në totalin e shpenzimeve. Kjo është si rezultat i operimit të 43 sistemeve të ndryshme të furnizimit me ujë, të cilat bazohen kryesisht në pompim të ujit. KRU Gjakova shpenzimet e energjisë i ka vetëm 8% nga pjesëmarrja në totalin e shpenzimeve operative.




Figura 27. Proporcioni i kategorive të shpenzimeve operative për sektorin 2020 dhe 2021

KRU duhet hartojnë dhe zbatojnë një plan të brendshëm me masa për reduktimin e kostove aktuale, fillimisht duke i identifikuar mungesën e efijencës financiare operative në të gjitha kosto qendrat.

2.5.4 Efikasitet i stafit

Efiçenca e stafit në KRU gjatë vitit 2021 është pasqyruar përmes treguesit në vijim, i cili tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt të angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura për 1000 konsumatorë.

Është shumë e rëndësishme të dihet se me çfarë efikasiteti i përdorin burimet njerëzore secila kompani. Sa për të bërë të qartë, vlerat më të ulëta tregojnë efiçencë më të madhe të stafit në KRU.




Figura 28. Efikasiteti i stafit

Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, efikasiteti i stafit në nivel të sektorit ka treguar trend pozitiv, rezultat i të cilës ka qenë rritja e numrit të konsumatorëve brenda zonave ekzistuese të shtrirjes së shërbimeve.

Edhe pse nuk ka një standard të përcaktuar për numrin e të punësuarve për 1000 konsumatorë, bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare rekomandohet të ketë më pak se 5 të punësuar për 1000 konsumatorë për të pasur efikasitet të mirë të stafit.

KRU Prishtina, KRU Hidrodrini dhe KRU Hidromorava, kanë arritur ti tejkalojnë këto praktika. Përndryshe efikasiteti shumë i ulët i stafit për vitin 2021 është treguar në KRU Gjakova, edhe pse krahasuar me vitin 2020 ka treguar trend pozitiv.

Objektiva e planifikuar me procesin tarifor për vitin 2021 në nivel të sektorit ka qenë 5.03, ky cak në nivel të sektorit është 4.84 që është rezultat shumë i mirë. Efikasiteti i stafit i realizuar edhe në nivel individual ishte me i ulët se ai i planifikuar te pothuaj të gjitha KRU-të, me përjashtim të KRU Gjakova.

Tabela 17. Efikasiteti i realizuar dhe ai i planifikuar për vitet 2020 dhe 2021

Efikasiteti i stafit	Realizimi	Planifikimi
KRU	2021	2021
PR	3.62	3.88
PZ	6.14	6.53
PE	4.32	4.54
MIT	5.92	6.00
GJA	6.69	6.08
FE	5.72	6.01
GJI	4.43	4.93
Sektori	4.84	5.03

3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE Ibër-Lepenci, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina.

Në vazhdim, po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendet e zhvillimit të performancës në vitin 2021 në raport me vitin 2020.

Tabelën 18. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2021 / 2020	2020	2021
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m ³)	51,200,467	48,708,395
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,293,828	1,199,496
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,255,533	1,074,248
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	1,465,915	1,627,610
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	81	79

Në vitin 2021 shitjet vëllimore kanë rënë për 5% krahasuar me vitin 2020. Shitjet më të ulta ishin realizuar për KRU Prishtina, nga 22.8 milion m³ janë 20.1 milion m³ apo 12% më pak, përderisa tek KRU Mitrovica shitjet vëllimore janë rritur për 1%, duke reflektuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve të ujit në vlerë monetare.

Shpenzimet për furnizimin e ujit me shumicë janë rritur në nivelin prej 11%, nga 1.5 mil sa ishin në vitin 2020 në 1.6 mil. për vitin 2021.

Në tabelën 15, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Ibër-Lepenci' gjatë vitit 2021/2020.

Tabela 19. Treguesit e Performancës së NHE Ibër-Lepenci

Treguesi i performancës	2020	2021
Shkalla e arkëtimit	97%	90%
Norma e punës	0.88	0.74
Norma e mbulimit të punës	0.86	0.66
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.029	0.033

Në vitin 2021 NHE Ibër-Lepenci ka realizuar shkallë të arkëtimit prej 90% dhe që është mospërmbushje nga caku prej 100%, kryesisht rezultat i mos pagesës së faturave për ujë me shumicë nga ana e KRU Mitrovica.

Rritja e shpenzimeve prej 11% dhe rënia e shitjeve të ujit prej 7% ka ndikuar që norma e punës të jetë më e ulët krahasuar me vitin 2020. Norma e mbulimit të punës ka rënë për 23% në raport me vitin 2020 dhe mbetet ende nën nivelin e dëshiruar për të mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2021 për shërbimet e ofruara, e kjo është rezultat i mos inkasimit në nivelin prej 100%.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2021 janë rritur në raport me vitin 2020 nga 0.029 euro/m³ në 0.033 euro/m³, si rezultat i rritjes së shpenzimeve të personelit.

SHTOJCA 1: PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE**KRU Prishtina (Prishtinë)**

	2020	2021
Qarkullimi	13,932,7102	14,389,147
Shpenzimet operative	10,099,459	10,254,012
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	3,833,243	4,135,138
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	634,113	678,841
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	3,199,130	3,456,294
Provizionimi i borxheve të këqija	773,506	2,401,692
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	2,425,623	3,456,294
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	2,425,623	1,054,605
Tatimi në profit		
Profiti neto pas tatimit	2,425,623	1,054,605

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

	2020	2021
Qarkullimi	4,898,130	5,119,987
Shpenzimet operative	3,886,757	3,872,999
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,011,373	1,246,988
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	74,548	131,097
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	936,825	1,115,891
Provizionimi i borxheve të këqija	250,032	332,707
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	686,793	783,184
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	686,793	783,184
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	686,793	783,184

KRU Hidrodrini (Pejë)

	2020	2021
Qarkullimi	3,871,781	4,022,313
Shpenzimet operative	2,561,795	2,903,741
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,309,986	1,118,572
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	131,101	133,622
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	1,178,885	984,950
Provizionimi i borxheve të këqija	234,722	805,181
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	944,163	179,768
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	944,163	179,768
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	944,163	179,768

KRU Mitrovica (Mitrovicë)

	2020	2021
Qarkullimi	4,466,254	4,604,978
Shpenzimet operative	3,535,423	3,363,491
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	930,831	1,241,487
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	21,183	24,819
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	909,648	1,216,668
Provizionimi i borxheve të këqija	754,022	1,213,853
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	155,626	2,833
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	155,626	2,833
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	155,626	2,833

KRU Gjakova (Gjakovë)

	2020	2021
Qarkullimi	4,576,868	4,687,018
Shpenzimet operative	3,697,304	3,642,510
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	879,564	1,044,508
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	474,353	366,332
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	405,211	678,176
Provizionimi i borxheve të këqija	72,451	209,196
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	332,760	468,980
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	332,760	468,980
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	332,760	468,980

KRU Bifurkacioni (Ferizaj)

	2020	2021
Qarkullimi	2,144,491	2,213,838
Shpenzimet operative	1,535,549	1,517,168
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	608,942	696,670
Mirëmbajtja kapitale (përritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	27,788	31,454
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	581,154	665,216
Provizionimi i borxheve të këqija	260,000	586,234
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	321,154	78,983
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	321,154	78,983
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	321,154	78,983

KRU Hidromorava (Gjilan)

	2020	2021
Qarkullimi	2,316,101	2,284,171
Shpenzimet operative	1,848,835	1,784,596
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	467,266	499,575
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukture + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	42,127	42,751
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	425,139	456,824
Provizionimi i borxheve të këqija	193,514	297,726
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	231,625	159,098
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	231,625	159,098
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	231,625	159,098

SHTOJCA 2: PËRMBLEDHJE TREGUESISH 2021

Treguesit	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Sektori
Mbulueshmëria me shërbime të ujit (%)	83	66	85	80	99	81	61	79
Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit (%)	78	65	45	60	67	74	50	65
Prodhimi i ujit (l/p/d)	348	212	346	385	252	182	185	292
Shitja e ujit (l/p/d)	146	97	144	209	145	78	96	135
Uji i fat. për kons. shtëpiak (l/d)	117	83	111	106	113	68	82	102
Uji i fat. për kons. shtëpiak (%)	80	86	77	83	77	87	86	81
Uji i fat. për kons. industrial-komercial (%)	12	9	12	10	8	9	9	10
Uji i fat. për kons. institucional (%)	8	5	11	7	15	5	5	9
Uji i Pa-faturuar (%)	58	54	58	55	42	57	48	55
Testet e dështuara në total (%)	0.7	4.3	11.8	0.0	0.0	4.6	3.9	1.9
Përqindja e konsumit të lexuar (%)	100	100	95	89	99	100	100	97
Efikasiteti i stafit total ('000 kons.)	3.62	6.14	4.32	5.92	6.69	5.72	4.43	4.84
Shpenzimet operative(€/m3/prodhuar)	0.05	0.10	0.01	0.06	0.02	0.04	0.07	0.05
Shpenzimet operative(€/kons)- ujësjellës	64	57	49	69	78	38	47	60
Shpenzimet operative(€/kons)-ujëra të ndotura	3	16	11	10	7	8	5	7
Shpenzimet kapitale (€/kons.)- ujësjellës	3	6	5	9	7	0	1	4
Shpenzimet kapitale (€/kons.)- ujëra të ndotura	7	0	0	1	0	0	0	3
Të ardhurat nga shitja (€/kons.)- ujësjellës	84	73	66	76	96	53	55	76
Të ardhurat nga shitja (€/kons.)- ujëra të ndotura	9	21	16	18	15	13	11	13
Nr. i ankesave ndaj shërbimeve ('000 kons.)	34	50	44	157	8	6	17	44
Shkalla e arkëtimit (%)	91	100	129	74	103	80	92	96
Shkalla e arkëtimit për kons. Shtëpiak (%)	87	100	93	74	107	80	91	91
Shkalla e arkëtimit për kons. komercial-industrial	104	96	267	81	101	93	92	120
Shkalla e arkëtimit për kons.institucional	97	108	107	66	84	42	100	93
Norma e mbulimit të punës	1.28	1.32	1.77	1.08	1.33	1.17	1.18	1.31

SHTOJCA 3: TË DHËNA STATISTIKORE 2021

Të dhënat	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Totali
Uji i prodhuar (m3)	55,175,048	16,928,504	24,842,768	27,457,562	15,910,071	8,258,735	7,801,252	156,373,940
Nr. i konsumatorëve total- Ujësllës	153,509	54,104	53,205	43,897	43,737	33,551	34,703	416,706
Konsumatorët total me ujëmatës	151,818	54,100	53,044	39,824	43,625	33,551	34,520	410,482
Ankesat - Ujësllës	5,293	2,691	2,339	6,870	341	191	583	18,308
Shpenzimet operative - Ujësllës	9,842,212	3,063,889	2,606,115	3,040,126	3,425,181	1,282,580	1,638,731	24,898,834
Shpenzimet kapitale nga KRU- Ujësllës	497,374	181,310	242,803	227,145	296,833	7,464	25,559	1,478,488
Shpenzimet kapitale nga Don.- Ujësllës	30,210	135,902	-	161,178	22,778	-	-	350,068
Sasia e ujit të faturuar m3	23,161,373	7,718,785	10,333,538	7,476,951 4,824,515	9,167,666	3,562,927	4,038,271	65,459,511 ⁶ 70,284,026 ⁷
Uji i faturuar me ujëmatës	23,142,402	7,718,785	9,838,249	6,180,459	9,109,407	3,562,927	4,028,125	63,580,354
Të ardhurat nga tarifa fikse	2,023,317	716,122	689,905	549,891	568,489	436,426	442,165	5,426,315
Totali i të ardhurave për furnizim me Ujësllës	10,903,269	3,248,840	2,827,348	2,775,180	3,625,612	1,342,834	1,482,080	26,205,163
Të hyrat tjera operative- Ujësllës	39,265	39,486	36,471	12,065	23,408	50,781	22,850	224,326
Nr. i konsumatorëve- Ujërave të Ndotura	148,686	52,074	27,354	30,822	30,915	29,954	29,540	349,345
Nr. i Ankesave- Ujërave të Ndotura	4,090	658	52	2,972	-	-	33	7,805
Shpenzimet operative për shërbime të Ujërave të Ndotura	411,799	809,109	297,627	323,364	217,329	234,589	145,865	2,439,683
Shpenzimet kapitale nga KRU- Ujërave të Ndotura	21,754	2,275	11,859	22,139	3,885	1,415	414	63,742
Shpenzimet kapitale nga Don. - Ujërave të Ndotura	979,931	-	-	15,941	529	-	-	996,401
Faturimi m3 për shërbimet e Ujërave të Ndotura	22,634,510	7,341,333	5,374,929	5,216,605	5,572,286	3,184,695	3,506,439	52,830,798
Të ardhurat nga shitja- Ujërave të Ndotura.	1,385,546	1,102,144	444,275	568,769	468,277	381,694	326,269	4,676,974
Të hyrat tjera operative - Ujërave të Ndotura	37,750	13,395	24,314	30,541	1,232	2,103	10,807	120,142
Subvencionet				691,030				
Totali i keshit të arkëtuar	13,074,944	5,063,171	5,090,905	2,889,570	4,817,042	1,721,950	2,069,864	34,727,445
Stafi i tërë i punësuar	556	332	230	260	293	192	154	2,017
Total popullata	524,027	331,895	231,476	201,424	174,874	154,225	189,367	1,807,288
Popullata e mbuluar me shërbime të Ujësllës	434,270	218,371	196,654	161,161	172,632	124,531	115,613	1,423,232
Popullata e mbuluar me shërbime të Ujërave të Ndotura	408,621	216,280	104,871	121,341	117,428	113,818	94,386	1,176,746
Gjatësia e rrjetit të Ujësllës	2,218	1,068	1,104	1,335	1,213	538	740	8,216
Gjatësia e rrjetit të Kanalizimit	1,100	270	182	277	81	504	245	2,659

⁶ Në vlerën prej 65,459,511 m3 nuk është përfshirë sasia e ujit me shumicë⁷ Në vlerën prej 70,284,026 m3 është përfshirë sasia e ujit me shumicë që faturohet për pjesën Veriore të Mitrovicës

SHTOJCA 4: PASQYRAT TARIFORE (2020-2021)

Pasqyra aktuale tarifore për vitin 2020

Njësia		KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Juçor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
Konsumatorët shtëpiak								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.43	0.38	0.25	0.36	0.37	0.35	0.34
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.05	0.13	0.07	0.09	0.07	0.12	0.08
Konsumatorët Komercial dhe Institucional								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.69	0.67	0.44	0.57	0.67	0.55	0.54
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.11	0.17	0.15	0.20	0.16	0.26	0.17

Tarifat e aplikueshme për vitin 2021 (1 Janar - 31 Dhjetor 2021)

Njësia		KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Juçor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava
Konsumatorët shtëpiak								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.43	0.38	0.25	0.34	0.37	0.35	0.34
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.05	0.14	0.07	0.09	0.07	0.10	0.08
Konsumatorët Komercial dhe Institucional								
Tarifa fikse për Furnizimin me Ujë	EUR/muaj	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00
Tarifa volumetrike për Furnizimin me Ujë	EUR/m ³	0.69	0.67	0.44	0.55	0.67	0.55	0.54
Tarifa për Ujëra të ndotura (bazuar në volumn e ujit të konsumuar)	EUR/m ³	0.11	0.32	0.15	0.20	0.16	0.23	0.17

Tarifat e ujit të patrajtuar për vitin 2020

KRU	Njësia tarifore	Viti 2020
Mitrovica	€/m ³	0.0163
Prishtina	€/m ³	0.0364

Tarifat e ujit të patrajtuar për vitin 2021

KRU	Njësia tarifore	Viti 2021
Mitrovica	€/m ³	0.0163
Prishtina	€/m ³	0.0364

Tarifa volumetrike për aktivitete themelore të ofrimit të shërbimeve të ujit më shumicë

KRU	Njësia tarifore	Viti 2020	Viti 2021
Mitrovica	€/m ³	0.17	0.17

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit

Rr.Ali pashë Tepelena, Nr.01

Prishtinë